



International
Labour
Organization

With funding from

 Austrian
Development
Cooperation

SHQIPËRIAT

► Fjalorth i termave



Të drejtat e autorit © Organizata Ndërkombëtare e Punës 2022
Publikuar për herë të parë 2022

Publikimet e Zyrës Ndërkombëtare të Punës gëzojnë të drejtat e autorit sipas Protokollit 2 të Konventës Universale të të Drejtave të Autorit. Sidoqoftë, fragmente të shkurtra prej tyre mund të riprodhohen pa autorizim, me kusht që të tregohet burimi. Për të drejtat e riprodhimit ose përkthimit, duhet të bëhet aplikimi në Publikimet e ONP-së (Të Drejtat dhe Licencimin), Zyra Ndërkombëtare e Punës, CH-1211 Gjenevë 22, Zvicër, ose me email: rights@ilo.org. Zyra Ndërkombëtare e Punës mirëpret aplikime të tilla.

Bibliotekat, institucionet dhe përdoruesit e tjerë të regjistruar në një organizatë për të drejtat e riprodhimit mund të bëjnë kopje në përputhje me licencat e lëshuara atyre për këtë qëllim. Vizitoni www.ifrro.org për të gjetur organizatën për të drejtat e riprodhimit në vendin tuaj.

ISBN: 9789220367070 (web PDF)

Përcaktimet e përdorura në publikimet e ONP-së, të cilat janë në përputhje me praktikën e Kombeve të Bashkuara, dhe prezantimi i materialit në të nuk nënkuptojnë shprehjen e ndonjë mendimi nga ana e Zyrës Ndërkombëtare të Punës në lidhje me statusin ligjor të çdo vendi, zone ose territori ose të autoriteteve të tij, ose në lidhje me caktimin e kufijve të tij.



Përgjegjësia për mendimet e shprehura në artikuj të nënshkruar, studime dhe kontribute të tjera u mbetet vetëm autorëve të tyre, dhe publikimi nuk nënkupton miratim nga Zyra Ndërkombëtare e Punës për mendimet e shprehura në to.

Referenca për emrat e firmave dhe produkteve dhe proceseve tregtare nuk nënkupton miratimin e tyre nga Zyra Ndërkombëtare e Punës, dhe mospërmendja e një firme të veçantë, produkti ose procesi tregtar nuk është një shenjë e mosmiratimit.

Informata mbi publikimet e ONP-së dhe produktet digjitale mund të gjenden në: www.ilo.org/publns.

► Përmbajtja

► Activation Aktivizimi	5	► Key skills/key competences Aftësitë kryesore/ kompetencat kyçe	19	► Reskilling Riaftësimi	29
► Apprenticeship Formimi nëpërmjet punës	5	► Learning outcomes Rezultatet mësimore	19	► School-to-work transition Kalimi nga shkolla në punë	31
► Benchmarking Benchmarking	7	► Level of qualifications Nivelet e kualifikimit	19	► Second chance education Arsimi (jo-formal, tranzicional) i mundësive së dyta	31
► Common quality assurance framework Kuari i përbashkët i sigurimit të cilësisë	7	► Lifelong learning Të nxënit gjatë të gjithë jetës	20	► Sector councils/ bodies Këshill sektoriale	31
► Competency-Based Framework Kuari i Referencës së Kompetencave	8	► Long-term unemployment Punëkërkuar të papunë afatgjatë	20	► Social dialogue (to include social partner) Dialogu Social	32
► Drop-out Braktisje	8	► Low skilled persons Person me kualifikim të ulët	20	► Core employability skills (Soft skills) Aftësitë kryesore të punësueshmërisë (Aftësitë e buta)	32
► Hard to employ Grupe të veçanta/ Punëkërkuar të disavantazuar	9	► Mentoring Mentor	22	► Transferability of learning outcomes Transferueshmëria e kualifikimeve	33
► Early intervention Ndërhyrje e hershme	11	► NEET NEET	22	► Traineeship Praktika profesionale	33
► Early warning system Sistemi i paralajmërimit të hershëm	11	► Outreach Gjurmimi/Evidentimi	24	► Tutoring Instruktorë të arsimit profesional / Specialisti i punësimit	33
► Education or training pathway Rruga e edukimit ose e trajnimit	11	► Mutual learning/ Peer learning Të mësuarit e ndërsjellë	24	► Unemployed I papunësuar	35
► Education or training provider Ofrues të shërbimeve arsimore, trajnuese	12	► Peer review Rishikimi nga kolegët	25	► Underqualification Nënkualifikimi	35
► Employability Punësueshmëria	12	► Post placement support Shërbimet mbështetëse pas-punësimit	25	► Upskilling Përmirësim i aftësive	35
► Employed I punësuar	12	► Preventive action Masa parandaluese	25	► Work-based learning Formimi nëpërmjet punës	37
► Flexible learning pathways Mënyrat fleksibël të të nxënit	14	► Precarious employment (work conditions) Punësimi i pasigurt (Kushtet e punës)	26	► Work life balance Ekuilibri mes punës dhe jetës	37
► Formal learning Të nxënit formal	14	► Probation period Koha e provës	26	► Youth Guarantee Garancia Rinore	38
► Good quality offer Ofertë cilësore	15	► Qualification system Sistemi i kualifikimeve	28	► Youth Guarantee Implementation Plan Plani i Zbatimit të Garancisë Rinore	38
► Inactive (inactive young people) Joaktive (Të rinjtë joaktiv)	17	► Recognition of prior learning Njohja e të nxënit paraprak	28	► Youth Organisations Organizatë për të rinjtë/ Organizatë rinore	39
► Initial education and training Arsim dhe trajnim fillestar	17	► Recognized vocational qualification Kualifikimi profesional formal	29	► Youth Work(ers) Punonjës për të rinjtë	39
► Job placement Sistemimi në tregun e punës	17	► Re-entrants Të riintegruarit	29		
		► Retraining Ritrajnimi	29		



► Activation Aktivizimi

Përkufizimi

Aktivizimi është zbatimi i një sërë masash dhe ndërhyrjesh të politikave sociale dhe programeve aktive të punësimit që synon forcimin e kapaciteteve të pjesëmarrësve për të hyrë në tregun e punës, si një parakusht bazë për përfshirjen e tyre sociale.

Në kontekstin e Garancisë Rinore, aktivizimi është (procesi) i përgatitjes së të rinjve që nuk janë të punësuar, që nuk janë duke ndjekur një shkollë apo një kurs formimi profesional (NEET) për të pranuar një ofertë punësimi, arsimimi apo trajnimi të mëtejshëm, trajnim në vendin e punës ose praktikë në punë sipas Garancisë Rinore. Ai përfshin një gamë të gjerë shërbimesh punësimi si këshillimi dhe orientimi për karrierë, ndërmjetësimi për punësim, trajnimi motivues, etj. Ai përfshin gjithashtu mjete për të përmirësuar klasifikimin e pjesëmarrësve, personalizimin e shërbimeve dhe qëndrueshmërinë e rezultateve (profilizimi, plani individual i punësimit, menaxhimi i rasteve, dhe shërbimet e pas-punësimit).

Komente

Aktivizimi nuk parashikohet si term nga legjislacioni aktual.

An Economic and Investment Plan for the Western Balkans

Flagship 10 – Youth Guarantee

<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52020DC0641>

Guidelines for the development of Youth Guarantee implementation plans

► Apprenticeship Formimi nëpërmjet punës

Përkufizimi


Të nxënit e aftësive profesionale që ndodh në mënyrë të alternuar në klasë dhe plotësohet nga praktikat në vendin e punës.

Komente

Për të ofruar një kornizë koherente për Praktikën Profesionale, bazuar në konceptin e mirëpranuar të asaj që konsiderohet cilësore dhe efektive, Këshilli nxori Rekomandimin mbi Kornizën Evropiane për Formimi nëpërmjet punës cilësor dhe efektiv.

An Economic and Investment Plan for the Western Balkans


<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52020DC0641>



▶ B

▶ C

▶ D



► Benchmarking Benchmarking

Përkufizimi

Matja/vlerësimi i një ndërhyrje/veprimi duke e krahasuar atë me diçka tjetër të mirëpranuar si standard.

Një proces sistematik që krahason aktivitetet, proceset dhe/ose performancën e një programi, organizate, vendi, etj. kundrejt një referimi teorik, politik ose ekzistues me qëllim identifikimin e mënyrave për të përmirësuar performancën.

Cedefop, Glossary – Quality in Education and Training
<https://www.cedefop.europa.eu/el/publications/4106>

► Common quality assurance framework Kuari i përbashkët i sigurimit të cilësisë

Përkufizimi

Një sërë parimesh, udhëzimesh dhe mjetesh të përbashkëta të zhvilluara nga Forumi Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin dhe Aftësimin Profesional dhe Grupi Teknik i Punës për Cilësinë në Arsimin dhe Aftësimin Profesional, si instrument për të mbështetur Shtetet Anëtare në promovimin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë në sistemet e arsimit profesional; për ofruesit e trajnimeve të arsimit dhe aftësimit profesional (AAP) në përmirësimin e ofertave të trajnimit dhe për individët që janë në proces të përvetësimit të aftësive dhe kompetencave më të mira.

Në legjislacionin vendas, sigurimi i cilësisë nënkupton tërësinë e aktiviteteve të planifikuara, të zbatuara, të vlerësuara e të raportuara, të cilat garantojnë që AFP-ja (përmbajtja e programeve, kurrikulat, vlerësimi dhe matja e rezultateve të të nxëniet) është në përputhje me kriteret e cilësisë.

Komente


Korniza e Përbashkët e Sigurimit të Cilësisë (KPSC) përbën një kornizë referuese evropiane për të siguruar dhe zhvilluar cilësinë në arsimin dhe trajnimin profesional (AFP), duke u mbështetur në parimet kryesore të modeleve ekzistuese të sigurimit të cilësisë.

Common Principles for Quality Assurance in Education and Training

The European Quality Assurance Reference Framework for Vocational Education and Training (EQUAVET):
[https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32009H0708\(01\)&from=EN](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32009H0708(01)&from=EN)

Standards and Guidelines for Quality Assurance in the European Higher Education Area:
https://www.enqa.eu/wp-content/uploads/2015/11/ESG_2015.pdf

Ligj nr. 15/2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën Shqipërisë”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 43, datë 9 mars 2017, Varianti i përditësuar.



► Competency-Based Framework

Kuadri i Referencës së Kompetencave


Përkufizimi

Kuadri i Referencës së Kompetencave përcakton njohuritë, aftësitë dhe karakteristikat e kërkuara nga individët e punësuar në një organizatë. Çdo pozicion (punë) parashikon një sërë kompetencash të nevojshme për performancë efikase.

Komente

Kuadri i Referencës së Kompetencave nuk parashikohet si term nga legjislacioni aktual.

Chartered Institute of Personnel and Development,
<https://www.cipd.co.uk/knowledge/fundamentals/people/performance/competency-factsheet#6374>



► Drop-out Braktisje

Përkufizimi

Fëmijët, nxënësit dhe të rriturit e të gjitha niveleve të arsimit të detyruar të cilët janë larguar nga sistemi arsimor përpara përfundimit të arsimit, p.sh. arritjes së nivelit përkatës të edukimit.

Komente

Kur nxënësit e moshës 6 deri 16 vjeç, të cilët i përfshin detyrimi shkollor, mungojnë pa arsye në shkollë ose e braktisin atë, prindërit e tyre dënohen për kundërvajtje administrative me gjobë nga 1000 deri në 10 000 lekë, si vijon:

- Kur nxënësi mungon në mësim pa arsye 30 – 50 për qind të kohës në 2 muaj të njëpasnjëshëm, masa e gjobës është 1 000 deri 3 000 lekë dhe, në rast përsëritjeje gjatë po atij viti, gjoba bëhet 5 000 lekë.
- Kur nxënësi mungon pa arsye mbi 50 për qind të kohës në 2 muaj të njëpasnjëshëm, masa e gjobës është 5 000 deri në 7 000 lekë dhe, në rast përsëritjeje gjatë po atij viti ose braktisjeje të shkollës, gjoba bëhet 10 000 lekë.
- Vendimi i gjobës jepet nga kryetari i bashkisë apo i komunës, sipas propozimit të drejtorit të shkollës.
- Kundër vendimit të gjobitjes mund të bëhet ankim brenda 10 ditëve nga dita e shpalljes së njoftimit në gjykatën e rrethit ku është kryer kundërvajtja. Përgjithësisht nga gjoba ata prindër, fëmijët e të cilëve janë regjistruar në një shkollë, shqiptare a të huaj, brenda vendit, me kusht që të paraqesin dokumentin e regjistrimit pranë drejtorisë së shkollës në vendbanimin e tyre. Përgjithësisht nga gjoba ata prindër, fëmijët e të cilëve janë regjistruar në një, shkollë jashtë vendit.

Ligji Nr.7952 Nr. 7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 15, datë 17 Korrik 1995, faqe 619, Varianti i përditësuar.

► Hard to employ Grupe të veçanta/ Punëkërkues të disavantazhuar

Përkufizimi


Në kontekst më të gjerë, grupet e veçanta përfshijnë kategoritë e mëposhtme: të varfër, familje me një prind, grupet minoritare, romë, të moshuar, persona me aftësi të kufizuara, të pastrehë, personat me varësi ndaj drogës dhe alkoolit, të papunët afatgjatë dhe braktisësit e shkollës.



Personat me vështirësi për t'u punësuar, janë individë të papunë të cilët e kanë të vështirë të gjejnë një punë për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore, arsimit të pamjaftueshëm ose të papërshtatshëm, karakteristikave socio-demografike, mospërputhjes rajonale ose profesionale të ofertës dhe kërkesës në tregun e punës, ose për rrethana të tjera objektive. Në veçanti, individët më në rrezik janë ata që përballen me disa faktorë vulnerabiliteti dhe paralelisht vështirësi për tu punësuar.

Sipas legjislacionit në Shqipëri, grupe të cënueshme konsiderohen punëkërkuesit apo të papunët si: individët me statusin e jetimit që ndodhen në kushte të vështira ekonomike; kryefamiljarë të vetëm, me fëmijë në ngarkim;

persona me aftësi të kufizuara, përfshirë personat që nuk dëgjojnë dhe invalidët e punës të vlerësuar pjesërisht të aftë për punë nga komisionet përkatëse; prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuar; persona me moshë mbi 55 vjeç; persona nga komuniteti rom dhe egjiptian; persona që kanë vuajtur dënimin me burgim, apo ndaj të cilëve është vendosur pezullimi i vendimit me burgim dhe zëvendësimi i tij me një dënim alternativ; persona nga familje që përfitojnë nga programet e mbështetjes me të ardhura; punëkërkues të papunë afatgjatë (të regjistruar si punëkërkues të papunë prej më shumë se një viti); punëkërkues të papunë, të kthyer prej jo më shumë se dy vjetësh nga emigracioni; të mitur dhe të rinj në konflikt me ligjin, sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur; të rinjtë me moshë nën 29 vjeç; viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit; viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe viktimat e dhunës në familje; nënat nën moshën 18 vjeç.

Ligj Nr. 15/2019 "Për nxitjen e punësimit"
botuar në Fletoren Zyrtare nr. 45, datë 3 prill 2019.





► Early intervention Ndërrhyrje e hershme


Përkufizimi

Politika e monitorimit të vazhdueshëm të grupeve potencialisht të cenueshme të rinjve - identifikimi i hershëm i nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm të cilët vlerësohen me risk për braktisjen e shkollës (mungesa, nota të dobëta), si dhe masat për reduktimin e braktisjes së hershme të shkollës dhe për të siguruar që të rinjtë kanë aftësitë e kërkuara për tregun e punës (p.sh. programet e arsimit të dyfishtë, sistemet e informacionit arsimor, sistemet e paralajmërimit të hershëm etj.).

An Economic and Investment Plan for the Western Balkans

<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52020DC0641>

European Commission: Reducing Early School Leaving: Key messages and policy support, Final Report of the Thematic Working Group on Early School Leaving (2013)



► Early warning system Sistemi i paralajmërimit të hershëm

Përkufizimi

Një mekanizëm i dizenuar për të identifikuar dhe paralajmëruar për rrezikun e largimit të hershëm nga sistemi arsimor. Ky term nënkupton parandalimin e braktisjes së hershme të shkollës dhe uljen e shkallës së braktisjes së shkollës, si dhe masat për edukimin e vazhdueshëm të fëmijëve dhe nxënësve që janë larguar nga sistemi.

► Education or training pathway Rruga e edukimit ose e trajnimit

Përkufizimi

Ky term përfshin aksesin, fleksibilitetin e mundësive për edukim në sistemin formal dhe joformal të arsimit.

Lëvizshmëria horizontale dhe vertikale u siguron studentëve dhe të rriturve mundësinë për të ndryshuar llojin e arsimit gjatë edukimit të tyre (lëvizshmëri horizontale) dhe mundësinë e arsimit të mëtejshëm dhe përvetësimit të një niveli më të lartë arsimor (lëvizshmëri vertikale).

► Education or training provider


Ofrues të shërbimeve arsimore, trajnuese

Përkufizimi

Në kontekst më të gjerë, termi përfshin çdo organizatë ose individ që ofron shërbime edukimi ose trajnimi.

Sipas legjislacionit vendas, ofrues i AFP-së është institucioni publik ose jopublik (person fizik ose juridik), i licencuar dhe/ose i akredituar për të ofruar programe/shërbime të AFP-së në Republikën e Shqipërisë.

Ligj nr. 15/2017 "Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 43, datë 9 mars 2017, Varianti i përditësuar.



► Employability

Punësueshmëria

Përkufizimi

Kombinimi i faktorëve që i mundësojnë individit të përparojë drejt punësimit ose të punësohet, të qëndrojë në punë dhe të përparojë gjatë karrierës së tij.

Sipas legjislacionit vendas, punësueshmëria nënkupton kombinimin e aftësive, njohurive dhe kompetencave që rrisin mundësitë e personit për t'u punësuar, për të qëndruar i punësuar dhe për të përparuar në karrierë.

Komente

Punësueshmëria e individit varet nga: atributet personale (përfshirë përshtatshmërinë e njohurive dhe aftësive); mënyrën se si prezantohen këto attribute personale në tregun e punës; ambienti dhe konteksti social (stimujt dhe mundësitë e ofruara për të përditësuar dhe provuar njohuritë dhe aftësitë e tyre); dhe konteksti ekonomik.

Cedefop, Glossary – Quality in Education and Training
<https://www.cedefop.europa.eu/en/publications/4106>

Ligj Nr. 15/2019 "Për nxitjen e punësimit" botuar në Fletoren Zyrtare nr. 45, datë 3 prill 2019.

► Employed


I punësuari

Përkufizimi

Personi fizik i punësuar për të kryer punë ose shërbime me pagesë për punëdhënësin.

▶ F

▶ G



► Flexible learning pathways

Mënyrat fleksibël të të nxënit

Përkufizimi

Mënyrat fleksibël të të nxënit janë një koncept ombrellë që përfshin mënyra të shumta të të mësuarit, të mirëhartuara që të plotësojnë nevojat e nxënësve të ndryshëm.

Mënyrat fleksibël të të nxënit: “Mundësitë për të aksesuar dhe riaksesuar arsimin për të gjitha moshat, pavarësisht nivelit të arsimit, lidhjet e forcuara ndërmjet strukturave formale dhe joformale dhe njohja, vlefshmëria dhe akreditimi i njohurive, aftësive dhe kompetencave të fituara përmes arsimit joformal dhe informal”.

Fleksibiliteti i sistemit të arsimit u mundëson studentëve të lëvizin brenda dhe ndërmjet arsimit, trajnimit dhe punësimit. Fleksibilitet do të thotë që të rinjtë mund t'i përshtatin rrugët e tyre të të mësuarit ndërsa përparojnë për t'iu përshtatur interesave dhe aftësive të tyre.

The United Nations Educational, Scientific and Cultural Organisation,

http://www.iiep.unesco.org/sites/default/files/ipf_concept_note_en_final_revised0521.pdf

European Centre for the Development of Vocational Training

<https://www.cedefop.europa.eu/en/tools/vet-toolkit-tackling-early-leaving/intervention-approaches/flexible-education-and-training-systems>

► Formal learning

Të nxënit formal


Përkufizimi

Të nxënit formal nënkupton procese të organizuara mësimore që zhvillohen në bazë të kurrikulave dhe programeve për arsimin fillor dhe të mesëm si dhe programeve të studimit për arsimin e lartë.

Sipas legjislacionit vendas, “Të nxënit formal” është një proces grumbullues i dijes, që kryhet në një mjedis të organizuar dhe të strukturuar, të tillë si: institucioni i arsimit të lartë, shkolla, qendra e formimit, në përputhje me kuadrin ligjor përkatës, ku individët, gradualisht, asimilojnë gjithnjë e më shumë entitete komplekse dhe abstrakte (koncepte, kategori, mënyra të të sjellit) dhe/ose përvetësojnë aftësi dhe kompetenca më të gjera.

Ligj nr. 15/2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 43, datë 9 mars 2017, Varianti i përditësuar.

Ligj Nr. 23/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 247, datë 4.3.2010, “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 70, datë 30 Maj 2018.



► Good quality offer Ofertë cilësore

Përkufizimi

Në kuadër të Garancisë Rinore, ofertat cilësore i referohen sasisë dhe cilësisë së shërbimeve dhe programeve që janë në dispozicion/ofrohen për të rinjtë, të cilat ju mundësojnë oferta cilësore për punësim, arsimim të vazhdueshëm, trajnim në punë apo praktikë, në përputhje me kuadrin e sigurimit të cilësisë.

Dokumentet udhëzuese të Komisionit Evropian përdorin përkufizimin e bazuar në rezultate, ku një ofertë cilësore është ajo që rezulton në integrimin e qëndrueshëm të tregut të punës. Me fjalë të tjera, një ofertë konsiderohet e cilësisë së mirë nëse i riu që përfiton prej saj nuk kthehet në papunësi apo pasivitet.

An Economic and Investment Plan for the Western Balkans

Flagship 10 – Youth Guarantee


<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52020DC0641>

European Commission, Frequently asked questions about the Youth Guarantee, April 2015

European Commission, The Youth Guarantee and Youth Employment Initiative three years on, Strasbourg, 2016



I
J



► Inactive (inactive young people) Joaktive (Të rinjtë joaktiv)

Përkufizimi

Popullsia joaktive përbëhet nga të gjithë personat e moshës 15 vjeç e lart që nuk klasifikohen si të punësuar ose të papunë. Personat joaktivë përfshijnë studentët, pensionistët, personat që bëjnë punët e shtëpisë, si dhe personat e tjerë që nuk kanë kryer asnjë punë me pagesë në javën e vëzhguar, nuk kanë kërkuar punë në mënyrë aktive ose nuk kanë mundur të fillojnë punën brenda dy javësh, pas javës së vëzhguar.

NEET - Të rinj që nuk janë të punësuar dhe as duke ndjekur arsimin apo formim profesional.

Komente

Në kuadër të Garancisë Rinore, të rinjtë e moshës 25-29 vjeç janë në shënjestër të masave dhe programeve për të rinjtë.

Përqindja e të rinjve NEET (mosha 15-24 vjeç) është një tregues për SDG 8 (8.6.1), "Promovimi i rritjes ekonomike gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësim të plotë, produktiv dhe punës së denjë për të gjithë".

Republic Office of Statistics, Labour Force Survey
<https://publikacije.stat.gov.rs/G2021/Pdf/G20215671.pdf>

Council Recommendation of 30 October 2020 on A Bridge to Jobs – Reinforcing the Youth Guarantee and replacing the Council Recommendation of 22 April 2013 on establishing a Youth Guarantee 2020/C 372/01
https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=uriserv%3AOJ.C_.2020.372.01.0001.01.ENG&toc=OJ%3AC%3A2020%3A372%3ATOC

United Nations,
https://unstats.un.org/sdgs/indicators/Global%20Indicator%20Framework%20after%202021%20refinement_Eng.pdf

► Initial education and training Arsim dhe trajnim fillestar

Përkufizimi

Arsimi fillestar përfshin edukimin fillestar, i cili zakonisht merret përpara fillimit të punës. Mund të zhvillohet në nivele të ndryshme arsimore (fillor, të mesëm ose të lartë) në fushën e arsimit të përgjithshëm ose profesional.

► Job placement Sistemimi në tregun e punës

Përkufizimi

Procesi i mbështetjes së individëve (studentë, të papunë) për të gjetur punë që përputhen me aftësitë e tyre.


Komente

Sistemimi në tregun e punës mund të kryhet nga shërbimet publike ose private të punësimit. Ai përfshin aktivitete të tilla si hartimi i CV-së, përgatitja për intervista, auditimi i aftësive, e kështu me radhë.

Cedefop, Glossary – Quality in Education and Training
<https://www.cedefop.europa.eu/el/publications/4106>

▶ K

▶ L



► Key skills/key competences

Aftësitë kryesore/ kompetencat kyçe

Përkufizimi

Kompetencat kyçe janë një grup njohurish, aftësish dhe qëndrimesh të integruara që i nevojiten çdo individ për përmbushjen dhe zhvillimin personal, përfshirjen në jetën shoqërore dhe punësim.

Kompetencat kryesore e të mësuarit gjatë gjithë jetës - aftësia për të përdorur njohuritë e fituara, aftësitë dhe qëndrimet e nevojshme për zhvillimin personal, shoqëror dhe profesional dhe të mësuarit e mëtejshëm. Këto kompetenca bazohen në synimet dhe standardet e të gjitha niveleve të arsimit si fusha të reja, të rëndësishme për përvetësimin e vazhdueshëm të kompetencave, jetës private, shoqërore dhe profesionale, si dhe përballimin e problemeve reale dhe situatave të kërkit.

The European Reference Framework (2018) recognizes 8 key competences for lifelong learning

A new skills agenda for Europe:

<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52016DC0381&from=EN>

► Learning outcomes

Rezultatet mësimore

Përkufizimi

Rezultatet mësimore janë përshkrime të qarta të asaj që studenti pritët të dijë, kuptojë dhe të jetë në gjendje të demonstrojë, ose kryej pas përfundimit të nivelit të caktuar arsimor.

► Level of qualifications

Nivelet e kualifikimit


Përkufizimi

Një sistem klasifikimi i kualifikimeve sipas përshkrimeve të sejcilit nivel të kualifikimeve (përshkrime të njohurive, aftësive, sjelljeve dhe qëndrimeve përkatëse).

Komente

Nivelet e kualifikimit, janë nivele të caktuara brenda hierarkisë së "Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve", nivelet dallohen sipas rritjes së ndërlikueshmërisë, thellësisë dhe pavarësisë në të mësuar.

Ligj nr. 15/2017 "Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 43, datë 9 mars 2017, Varianti i përditësuar.



► Lifelong learning


Të nxënit gjatë të gjithë jetës

Përkufizimi

Të nxënit gjatë të gjithë jetës përfshin të gjitha format e të mësuarit dhe nënkupton pjesëmarrjen në forma të ndryshme të veprimtarive edukative gjatë gjithë jetës, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të kompetencave të nevojshme personale, qytetare, sociale dhe kompetencave të tjera të nevojshme për punë.

Sipas legjislacionit vendas, të nxënit gjatë gjithë jetës është i gjithë aktiviteti i mësimnxënies i realizuar gjatë jetës, i cili çon në përmirësimin e njohurive, shprehive, aftësive, kompetencave dhe/ose kualifikimeve për arsye personale, shoqërore dhe/ose profesionale.

Ligj nr. 15/2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 43, datë 9 mars 2017, Varianti i përditësuar.



► Long-term unemployment

Punëkërkues të papunë afatgjatë

Përkufizimi

Të papunë afatgjatë konsiderohen ata individë që janë duke kërkuar punë prej të paktën 12 muajsh.

Sipas legjislacionit vendas, punëkërkues të papunë afatgjatë konsiderohen punëkërkues të regjistruar si të papunë prej më shumë se një viti.

Ligj Nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit” botuar në Fletoren Zyrtare nr. 45, datë 3 prill 2019.

► Low skilled persons

Person me kualifikim të ulët

Përkufizimi

Personat pa kualifikim ose me kualifikim të ulët.


Komente

Niveli standard nën të cilin individ konsiderohet me kualifikim të ulët varet nga konteksti (nga niveli i përgjithshëm i arsimit në një shoqëri, ose nga shpërndarja e kualifikimeve brenda një profesioni, etj.). Në Europë, individët përgjithësisht konsiderohen me kualifikim të ulët kur kanë një nivel më poshtë se sa niveli i arsimit të mesëm.

Cedefop, Glossary – Quality in Education and Training
<https://www.cedefop.europa.eu/en/publications/4106>

▶ M

▶ N



► Mentoring Mentor

Përkufizimi

Mentorimi nënkupton bashkëpunimin ndërmjet përdoruesve të shërbimeve të punësimit dhe mentorëve, i cili zhvillohet në një vend, më së shpeshti në një mjedis të caktuar pune (p.sh. ndërmarrje).

Mentorët janë persona me kualifikimin e kërkuar, të cilët ofrojnë mbështetje profesionale për përdoruesit e shërbimit të mentorimit për të kryer me sukses aktivitetet e planifikuara p.sh detyra operacionale apo profesionale.

► NEET NEET

Përkufizimi

Të rinj që nuk janë të punësuar dhe as duke ndjekur arsimin apo formim profesional.

Komente

Në kuadër të Garancisë Rinore, të rinjtë e moshës 25-29 vjeç janë në shënjestër të masave dhe programeve për të rinjtë.


Përqindja e të rinjve NEET (mosha 15-24 vjeç) është një tregues për SDG 8 (8.6.1), "Promovimi i rritjes ekonomike gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësim të plotë, produktiv dhe punës së denjë për të gjithë".

Albanian Institute of Statistics
Labour Force Survey

Council Recommendation of 30 October 2020 on A Bridge to Jobs – Reinforcing the Youth Guarantee and replacing the Council Recommendation of 22 April 2013 on establishing a Youth Guarantee 2020/C 372/01


https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=uriserv%3AOJ.C_.2020.372.01.0001.01.ENG&toc=OJ%3AC%3A2020%3A372%3ATOC

United Nations,
https://unstats.un.org/sdgs/indicators/Global%20Indicator%20Framework%20after%202021%20refinement_Eng.pdf



▶ O

▶ P



► Outreach Gjurmimi/Evidentimi

Përkufizimi


Gjurmimi/Evidentim përfshin ndërhyrjet që identifikojnë, kontaktojnë dhe angazhojnë të rinjtë NEET, përmes aktiviteteve në nivel vendor (si puna në terren), ose përmes bashkëpunimit ndërsektorial ose bashkëpunimit ndërmjet ofruesve të shërbimeve.

Komente

Termi përdoret kryesisht në kontekstin e identifikimit dhe angazhimit të individëve të rinj që janë të panjohur për ofruesit e shërbimeve publike (p.sh. individë të rinj që nuk janë të regjistruar në shërbimet publike të punësimit ose qendrat sociale). Kategoritë e synuara përfshijnë të rinjtë që janë “të vështirë për t’u arritur” (të cilët kanë lënë shkollën herët, janë shkëputur nga tregu i punës, përballen me probleme sociale si abuzimi me substancat narkotike, të rinjtë e pastrehë, etj.) dhe që nuk janë të regjistruar dhe për rrjedhojë nuk mund të marrin mbështetjen e nevojshme.

European Commission
Effective outreach to NEETs
Experience from the ground
<https://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=738&langId=en&pubId=8136&furtherPubs=yes>

Preparation of Youth Guarantee Implementation Plans in WB
<https://www.rcc.int/download/docs/Youth-Employment-leaflet.pdf/4c5269263e746ff7c596eeb9861fde2e.pdf>



► Mutual learning/ Peer learning Të mësuarit e ndërsjellë

Përkufizimi

Të mësuarit e ndërsjellë është një proces përmes të cilit individ mësion nga dhe me të tjerët. Ai përfshin një sërë mekanizmesh që mbështesin të mësuarit nga dhe me pjesëmarrësit. Në aktivitetet e të nxënës bashkëpunues, pjesëmarrësit në të njëjtën kohë mësojnë dhe kontribuojnë duke shkëmbyer njohuri, ide dhe përvoja.

Komente

Programi i të mësuarit të ndërsjellë u hartua në kuadër të Strategjisë Evropiane të Punësimit me synimin për të mbështetur, koordinuar dhe inkurajuar të mësuarit e ndërsjellë ndërmjet shteteve anëtare të BE-së për të ndihmuar përparimin drejt qëllimeve të Strategjisë Evropiane të Punësimit, kontributit në politikën në nivel kombëtar dhe nivel të BE-së si dhe dhe shpërndarjen e rezultateve tek audienca më e gjerë.

Aktivitetet/instrumentet që përdoren përfshijnë eksperimentat e të mësuarit nga kolegët dhe konferencat publike dhe bazën e të dhënave të praktikave të mira të tregut të punës.

European Commission, Mutual Learning Programme - Employment, Social Affairs & Inclusion,
<https://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=1047>

European Training Foundation,
https://www.etf.europa.eu/sites/default/files/2019-10/peer_visit_manual_summary_version_final_0.pdf

► Peer review Rishikimi nga kolegët

Përkufizimi

Rishikimi nga kolegët është aktivitet mësues i organizuar nga shteti që dëshiron të prezantoj shembullin e një praktike të mirë (politikë ose praktikë) për një grup shtetesh homologe (mund të ftohen deri në 10 shtete).

Qëllimi është të diskutohet një temë specifike, me synimin e identifikimit të aspekteve të transferueshme dhe të mësuarit nga praktikatat e mira dhe/ose mbështetja për zbatimin e politikave ose praktikave emergjente.

European Commission,
<https://ec.europa.eu/social/main.jsp?langId=en&catId=1070>

► Post placement support Shërbimet mbështetëse pas-punësimit

Përkufizimi

Mbështetja pas punësimit do të thotë mbështetje dhe ndihmë që u ofrohet pjesëmarrësve dhe/ose punëdhënësve për të mbajtur në punë të punësuarin.

Ai mund të përfshijë mbështetje për ofrimin e trajnimit, mentorimit, subvencionet për pagat; pajisjet ose mbështetje të tjera relevante.

<https://www.lawinsider.com/dictionary/post-placement-support>

► Preventive action Masa parandaluese

Përkufizimi

Masat parandaluese synojnë eliminimin e shkaqeve që mund të shkaktojnë mospërputhje me tregun e punës. Në kontekstin e Garancisë Rinore, këto masa i referohen një sërë politikash dhe masash parandaluese brenda sistemit arsimor, të kombinuara me masa specifike që synojnë reduktimin e dështimit në shkollë dhe braktisjen e hershme të shkollës.


Komente

Parandalimi përfshin ndërhyrjet e mëposhtme: akses në arsim cilësor, kurrikula të përshtatura dhe përditësuara, fleksibilitet në mënyrat e të mësuarit, kalim të butë ndërmjet niveleve arsimore, arsim profesional cilësor dhe me interes, mësues të përgatitur, sistem të fortë orientimi në karrierë, etj.

<https://www.iso.org/obp/ui/#iso:std:iso:9000:ed-4:v1:en>

Council Recommendation of 28 June 2011 on policies to reduce early school leaving, OJC 191, 2011
[https://eur-lex.europa.eu/legal-content/GA/TXT/?uri=celex:32011H0701\(01\)](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/GA/TXT/?uri=celex:32011H0701(01))

European Commission, Reducing Early School Leaving: Key messages and policy support. Final Report of the Thematic Working Group on Early School Leaving, 2013
https://ec.europa.eu/education/content/reducing-early-school-leaving-key-messages-and-policy-support_en



► Precarious employment (work conditions)

Punësimi i pasigurt (Kushtet e punës)


Përkufizimi

Punësimi i pasigurt i referohet individëve të punësuar të cilëve iu është pamundësuar siguria dhe qëndrueshmëria që zakonisht lidhet me punësimin me kohë të pjesshme dhe periudhë të pacaktuar.

Komente

Punësimi i pasigurt nuk parashikohet si term nga legjislacioni aktual.

ILO



► Probation period

Koha e provës

Përkufizimi


Një periudhë kohore gjatë së cilës punëdhënësi vlerëson aftësitë profesionale dhe aftësitë për të punuar të punonjësit të mundshëm për të kryer punën.

Punësimi gjatë periudhës së provës është i kushtëzuar - Gjatë periudhës së provës, punonjësi duhet të tregojë se zotëron ekspertizë, aftësi, praktikë, rutinë, shkathtësi, dhe cilësi të tjera, të cilat mund të verifikohen vetëm gjatë praktikës në punë.

Periudha e provës nuk mund zgjasë me shumë se gjashtë muaj.


Sipas legjislacionit vendas, konsiderohen si kohë prove 3 muajt e parë të punës, me përjashtim të rasteve kur palët kanë lidhur një kontratë për kryerjen e së njëjtës punë. Koha e provës mund të reduktohet ose hiqet me marrëveshje me shkrim ose me kontratë kolektive. Gjatë kohës së marrjes në provë, secila nga palët mund të zgjidhë kontratën duke i njoftuar vendimin e saj palës tjetër të paktën 5 ditë përpara.

Ligji nr. 7961 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë",
Miratuar më 12/07/1995, Varianti i përditësuar.



▶ Q

▶ R



► Qualification system Sistemi i kualifikimeve


Përkufizimi

Një sistem që rregullon kualifikimet, qëllimin, synimet dhe parimet e tyre, llojet dhe nivelin e kualifikimeve, mënyrat e marrjes së kualifikimeve, përshkrimet e njohurive, aftësive, sjelljeve për çdo nivel kualifikimi, organet dhe organizatat përgjegjëse për zbatimin dhe zhvillimin e Kornizës Kombëtare e Kualifikimeve (KKK), sigurimin e cilësisë në zbatimin e KKK dhe lidhjet me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (KEK).

Komente

“Sistemi i kualifikimeve” nënkupton sistemin e plotë brenda të cilit jepen dhe certifikohen kualifikimet, që përfshijnë kornizën kombëtare të kualifikimit dhe dispozitat ligjore për rregullimin e dhënies së kualifikimeve.

Ligj Nr. 23/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 247, datë 4.3.2010, “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 70, datë 30 Maj 2018.



► Recognition of prior learning Njohja e të nxënit paraprak

Përkufizimi


Njohja e të nxënit paraprak është një veprimtari edukative, e cila ka si qëllim që përmes vlerësimit të njohurive, aftësive dhe kompetencave të fituara përmes të mësuarit, përvojës jetësore apo të punës, të mundësoj të mësuarit e mëtejshëm dhe rritjen e kompetencave relevante për tregun e punës.

Njohja e të nxënit paraprak është një procedurë në të cilën, duke përdorur instrumentet e vlerësimit të njohurive, aftësive, dhe qëndrimeve (rezultatet e të nxënit) dhe kompetencat e një kandidati përcaktohet /ripërcaktohet standardi i kualifikimit të fituar përmes arsimit, jetës ose përvojës së punës.

Komente

Aktualisht, nuk ka një sistem të ngritur për njohjen e të nxënit paraprak në Shqipëri.

Projektvendim “Për Sistemin e Njohjes së të Nxënit të Mëparshëm Joformal dhe Informal”



► Recognized vocational qualification

Kualifikimi profesional formal

Përkufizimi

Kualifikimi është njohje zyrtare e të arritjeve, me të cilin njihet përfundimi i arsimit ose aftësimi, ose realizimi i kënaqshëm në një test ose provim.

Sipas legjislacionit vendas, kualifikimi është formalizimi i një procesi vlerësimi dhe vlefshmërie, i përfutur prej një organi kompetent/institucioni arsimor, të akredituar, që përcakton se individ ka arritur një nivel të caktuar njohurish, aftësish dhe kompetencash në përputhje me një standard të dhënë.

Ligj Nr. 23/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 247, datë 4.3.2010, “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 70, datë 30 Maj 2018.

► Re-entrants

Të riintegruarit

Përkufizimi

Një nga shtatë (7) nënkategoritë e NEET, p.sh. të rinjtë që kanë gjetur punë ose janë regjistruar në shkollë ose trajnim profesional dhe së shpejti duhet të largohen nga kategoria NEET.

Komente

Ky grup është zakonisht i vogël në madhësi dhe në përgjithësi nuk është shkak shqetësues për politikëbërësit.

M. Mascherini, S. Ledermaier: Exploring the diversity of NEETs (Eurofound, 2016)

► Retraining

Ritrajinimi

Përkufizimi

Ritrajinimi dhe aftësimi janë aktivitete që u ofrojnë të papunëve dhe të punësuarve, të cilëve nuk mund t’u sigurohet apo garantohet punësim i përshtatshëm, mundësia për të përvetësuar njohuri dhe aftësi të reja përmes punësimit dhe praktikës në punë, p.sh për të krijuar mundësi punësimi dhe vetëpunësimi.

► Reskilling

Riaftësimi

Përkufizimi



Riaftësimi nënkupton mundësinë për të kryer një detyrë specifike pune, rol ose funksion brenda një pune; prandaj, nevojat për riaftësim mund të përkufizohen si punë që punëdhënësit ofrojnë dhe kërkojnë të kryhen.

Aftësitë fitohen nëpërmjet sistemit të edukimit formal, joformal dhe informal dhe procesit të njohjes së mësimi paraprak.

Komente

Aftësitë mund të fitohen edhe përmes procesit të kryerjes së detyrave të caktuara, ndërsa aftësitë e buta janë karakteristika ose cilësi personale të individit.

ST



► School-to-work transition

Kalimi nga shkolla në punë

Përkufizimi

Kalimi nga shkolla në punë përcaktohet si kohëzgjatja midis përfundimit të arsimit (qoftë pas diplomimit ose braktisjes përpara përfundimit të nivelit të caktuar arsimor) deri në integrimin në punësim të rregullt.

Komente

Metodologjia e anketës së ILO-s tranzicioni nga shkolla në punë

Tranzicioni në tregun e punës përkufizohet si kalimi i një individi të ri (15 - 29 vjeç), nga përfundimi i shkollimit (ose hyrja në aktivitetin e parë ekonomik) në punën e parë të qëndrueshme ose të kënaqshme.

SWTS survey: A methodological guide
https://www.ilo.org/employment/Whatwedo/Instructionmaterials/WCMS_140857/lang--en/index.htm

► Second chance education

Arsimi (jo-formal, tranzicional) i mundësive së dyta

Përkufizimi

Arsimi i mundësisë së dyta është një bllok organizativ dhe programor ku të rriturit marrin arsim fillestar të përshtatshëm me nevojat e tyre, aftësitë e të nxënësve dhe nevojat e tregut të punës.


► Sector councils/bodies

Këshill sektoriale

Përkufizimi

Ligji “Për Nxitjen e Punësimit” ngarkon NAVETQ të ngrejë Komitetet Sektoriale të Aftësive Profesionale.

Ligj Nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit” botuar në Fletoren Zyrtare nr. 45, datë 3 prill 2019.



► Social dialogue (to include social partner) Dialogu Social

Përkufizimi

Dialogu social përkufizohet nga ILO për të përfshirë të gjitha llojet e negociatave, konsultimeve ose thjesht shkëmbimit të informacionit ndërmjet përfaqësuesve të qeverisë, punëdhënësve dhe punëtorëve, për çështje me interes të përbashkët që lidhen me politikën ekonomike dhe sociale. Qëllimi kryesor i dialogut social është të promovojë ndërtimin e konsensusit dhe përfshirjen demokratike midis aktorëve kryesorë në botën e punës.

Ai mund të ekzistojë si një proces trepalësh, me qeverinë si palë zyrtare në dialog ose mund të përbëhet nga marrëdhënie dypalëshe vetëm ndërmjet punëtorëve dhe punëdhënësve (ose sindikatave dhe organizatave të punëdhënësve), me ose pa përfshirje indirekte të qeverisë.

Mund të zhvillohet në nivel kombëtar, rajonal ose në nivel ndërmarrjeje.

Komente

Konventat e ILO-s që janë të rëndësishme për dialogun social përfshijnë: Konventën për të Drejtën e Organizimit dhe Bisedimeve Kolektive, 1949 (Nr. 98); Konventa mbi Konsultimet Trepalëshe, 1976 (Nr. 144); Konventa mbi Bisedimet Kolektive, 1981 (Nr. 154).

Në nivel të BE-së, instrumenti përkatës është Direktiva 2002/14/KE, datë 11 Mars 2012 që vendos një kuadër të përgjithshëm për informimin dhe konsultimin e punonjësve në Komunitetin Evropian.

International Labour Organization

[%20%20a">https://www.ilo.org/ifpdial/areas-of-work/social-dialogue/lang--en/index.htm](https://www.ilo.org/ifpdial/areas-of-work/social-dialogue/lang--en/index.htm)


► Core employability skills (Soft skills) Aftësitë kryesore të punësueshmërisë (Aftësitë e buta)

Përkufizimi

Aftësitë e buta, të ndërthurura ose të transferueshme janë tipare ose cilësi personale të karakterit të personi. Ato përfshijnë qëndrimet, zakonet dhe mënyrën se si ne komunikojmë dhe trajtojmë njerëzit e tjerë dhe si shkojmë mirë në mjedisin profesional dhe të përditshëm.

Komente

Disa shembuj të aftësive të buta përfshijnë: komunikimin, aftësitë ndërpersonale, aftësitë për të zgjidhur problemet, aftësitë e të menduarit kritik, aftësitë e të dëgjuarit aktiv, aftësitë e të mësuarit aktiv, aftësitë organizative, aftësitë e menaxhimit të kohës, të punuarit në grup, etikën profesionale, etj.



► Transferability of learning outcomes

Transferueshmëria e kualifikimeve

Përkufizimi

Transferueshmëria e kualifikimeve nënkupton shkallën në të cilën njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që i përkasin kualifikimit përkatës mund të përdoren në një mjedis të ri profesional ose arsimor dhe/ose të vërtetohen dhe certifikohen.

Cedefop, Glossary – Quality in Education and Training
<https://www.cedefop.europa.eu/el/publications/4106>

► Traineeship

Praktika profesionale

Përkufizimi

Praktike pune në një biznes, institucion publik ose organizatë jofitimprurëse në mënyrë që të fitojnë përvojë të vlefshme pune praktike përpara fillimit të punësimit të rregullt.

Komente

Për të ofruar një kornizë koherente për Praktikën Profesionale, bazuar në konceptin e mirëpranuar të asaj që konsiderohet cilësore dhe efektive, Këshilli nxori Rekomandimin mbi Kornizën Evropiane për Praktikën profesionale cilësore dhe efektive. Në Shqipëri praktika profesionale rregullohet nga Vendimi Nr. 17, datë 15. 1. 2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale” dhe Udhëzimin “Për disa ndryshime dhe shtesa në rregulloren Nr. 6

Prof, datë 21. 10. 2020 “Për zbatimin e Programeve të Nxitjes së Punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale”, e ndryshuar.


► Tutoring


Instrukturë të arsimit profesional / Specialisti i punësimit

Përkufizimi

Çdo aktivitet që ofron udhëzim, këshillim ose mbikëqyrje nga një profesionist kompetent dhe me përvojë. Tutori e mbështet nxënësin gjatë gjithë procesit mësimor (në shkollë, në qendra trajnimi ose në punë).

Cedefop, Glossary – Quality in Education and Training
<https://www.cedefop.europa.eu/el/publications/4106>






► Unemployed I papunësuar

Përkufizimi

Personi i papunësuar duhet të kuptohet si person i cili është së paku 15 deri në 65 vjeç (mund t'i referohemi pragut të moshës për daljen në pension), i cili është i aftë dhe i gatshëm për të punuar menjëherë, që nuk ka qenë i punësuar ose ka ushtruar të drejtën e punës, që është i regjistruar në Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive dhe kërkon në mënyrë aktive punë (përbush siç duhet të gjitha kërkesat ligjore dhe angazhimet e përcaktuara nga plani individual i punësimit).

Sipas legjislacionit vendas, punëkërkues i papunë, i regjistruar është punëkërkuesi, i cili deklaron në institucionin përkatës, që nuk është në marrëdhënie pune ose i vetëpunësuar dhe është i gatshëm menjëherë për punësim.

Ligj Nr. 15/2019 "Për nxitjen e punësimit" botuar në Fletoren Zyrtare nr. 45, datë 3 prill 2019.



► Underqualification Nënkualifikimi

Përkufizimi

Mospërputhje mes njohurive, aftësive dhe kompetencave të një individi me kërkesat e një pune ose në përgjithësi të tregut të punës.

Komente

Nënkualifikimi mund t'i referohet nën-arsimit (situatë në të cilën individi ka nivel arsimor më të ulët se ai që kërkohet për punë) ose nënkualifikim (situata në të cilën individit i mungojnë aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për të kryer punën me standarde të pranueshme).

Cedefop, Glossary – Quality in Education and Training
<https://www.cedefop.europa.eu/el/publications/4106>

► Upskilling Përmirësim i aftësive

Përkufizimi

Trajnim afatshkurtër, i cili ofrohet zakonisht pas arsimit ose trajnimit fillestar dhe synon plotësimin, përmirësimin ose përditësimin e njohurive, aftësive dhe/ose kompetencave të fituara gjatë trajnimit të mëparshëm.

Komente



Aftësia është mundësia për të kryer një detyrë specifike, rol ose funksion në kuadër të punës; prandaj, nevojat për aftësi mund të përkufizohen si punë që punëdhënësit ofrojnë dhe kërkojnë të kryhen.

Aftësitë fitohen nëpërmjet sistemit të edukimit formal, joformal dhe informal si dhe njohjes së mësimit paraprak.

Cedefop, Glossary – Quality in Education and Training
<https://www.cedefop.europa.eu/el/publications/4106>

W

Y



► Work-based learning Formimi nëpërmjet punës

Përkufizimi

Programi i formimit nëpërmjet punës ka si qëllim trajnimin në punë të punëkërkuësve, sipas nevojave të profilit të punës të kërkuar nga punëkërkuësit dhe përshtatur me nevojat e punëdhënësit;

- plani individual i trajnimit hartohet nga punëdhënësi e miratohet nga strukturat përkatëse të institucionit përgjegjës për punësimin dhe aftësitë;
- çdo punëdhënësi cakton të paktën një trajner për çdo grup përfituesish, nga një deri në shtatë persona përfitues, të përfshirë në program;

Programi subvencionon kostot e mëposhtme:

- Kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore (pjesën e kontributeve të punëdhënësit), të llogaritura në bazë të pagës minimale në shkallë vendi, të ofruara gjatë gjithë kohëzgjatjes së formimit, të kompensuara çdo muaj;
- Financimin e pagës në shumën 100 % të pagës minimale në shkallë vendi të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, të kompensuara çdo muaj;
- Kontributet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore (pjesën e kontributeve të punëdhënësit) për tetë muajt e ardhshëm, të llogaritura në bazë të pagës minimale në shkallë vendi, në rastet, kur, pas përfundimit të formimit nëpërmjet punës, punëdhënësi lidh kontratë punësimi të paktën tetëmuajore me punëmarrësin pas përfundimit të programit;
- Pagesën për mentorin në vlerën 2 000 lekë për çdo përfitues, pjesëmarrës të angazhuar nga ky punëdhënësi.


Kohëzgjatja e subvencionimit do të jetë për një periudhë katërmujore për të gjitha profesionet.

Decision no.17, dated 17.01.2020 "On the procedures, criteria and rules for the implementation of employment promotion programs through employment, on-the-job training and internships."

► Work life balance Ekujlibri mes punës dhe jetës

Përkufizimi

Ky term nuk është parasikuar nga legjislacioni aktual apo strategjitë relevante në Shqipëri.



► Youth Guarantee Garancia Rinore

Përkufizimi

Garancia Rinore është skemë aktivizimi, e cila synon që të gjithë të rinjtë brenda një periudhe katërmujore pasi kanë mbetur të papunë ose mbaruar arsimin formal, tju sigurohet një ofertë cilësore punësimi, arsimit të vazhdueshëm, formimin në punë/aprentership ose praktike.

Komente

Garancia Rinore bazohet në katër (4) shtylla/faza:

1. Ndërhyrja e hershme;
2. Gjetja dhe kontaktimi i NEET të paregjistruar;
3. Ofrimi i asistencës profesionale për kërkimin e punës dhe përmirësimin e kompetencave të të rinjtë për kërkim aktiv të punës, informacion dhe këshillim për mundësitë e zhvillimit të karrierës;
4. Ofertë për punë, arsim profesional, praktikë ose trajnim.

Council Recommendation of 22 April 2013 on establishing a Youth Guarantee

<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/ALL/?uri=celex%3A32013H0426%2801%29>

Council Recommendation of 30 October 2020 on A Bridge to Jobs – Reinforcing the Youth Guarantee and replacing the Council Recommendation of 22 April 2013 on establishing a Youth Guarantee 2020/C 372/01

https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=uriserv%3AOJ.C_.2020.372.01.0001.01.ENG&toc=OJ%3AC%3A2020%3A372%3ATOC

► Youth Guarantee Implementation Plan Plani i Zbatimit të Garancisë Rinore

Përkufizimi

Plani i Zbatimit të Garancisë Rinore është dokumenti kryesor kombëtar që duhet të identifikojë masat e planifikuara; afatet për zbatimin e tyre, buxhetin, ndryshimet e nevojshme në kuadrin ligjor, përcaktimin e një organi qendror koordinues dhe rolet e autoriteteve publike (ministritë e linjës dhe agjencitë e tyre, përfshirë shërbimet e punësimit dhe qendrat për punë sociale, institucionet arsimore dhe trajnuese duke përfshirë shkollat e AFP-së, etj.) dhe palët e interesuara (punëdhënësit dhe sindikatat, dhomat e tregtisë, organizatat rinore, OJQ-të, etj.).


Komente

Planet për zbatimin e Garancisë Rinore janë iniciuar në nivel të vendeve të BE-së, në vitin 2014, në zbatim të Rekomandimit të Këshillit të vitit 2013.

An Economic and Investment Plan for the Western Balkans

Flagship 10 – Youth Guarantee

<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52020DC0641>



► Youth Organisations

Organizatat për të rinjtë/ Organizatat rinore

Përkufizimi

Organizatat për të rinjtë janë ndër aktorët e zbatimit të politikave për të rinjtë dhe aktiviteteve për të rinjtë.

Sipas legjislacionit vendas, organizatat për të rinjtë janë persona juridikë jofitimprurës, të krijuar dhe të regjistruar në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizatat jofitimprurëse, që në fushën e veprimtarisë së tyre kanë për qëllim edhe mbrojtjen e zhvillimin e interesave të të rinjve dhe që kanë përvojë në zbatimin e programeve me ndikim për të rinjtë.

Organizatat rinore janë persona juridikë jofitimprurës, të krijuar dhe të regjistruar në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizatat jofitimprurëse, që kanë si objekt të veprimtarisë së tyre përfaqësimin, mbrojtjen dhe zhvillimin e interesave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse.

Ligj Nr. 75/2019 "Për rininë", botuar në Fletoren Zyrtare nr.180, më 27/12/2019.

► Youth Work(ers)


Punonjës për të rinjtë


Përkufizimi

Punonjës për të rinjtë është një ekspert i angazhuar në organizatat e shoqërisë civile/ institucionet/qeverisjen vendore, i cili zhvillon aktivitete të punës për të rinjtë.

Komente

Ky koncept nuk parashikohet nga legjislacioni ekskluziv.





ilo.org

Organizata Ndërkombëtare e Punës
Route des Morillons 4
1211 Geneva 22
Switzerland

 International Labour Organization
 @ILO
 ILOTV